

LIGJ
Nr. 29/2021

**PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE TË VENDEVE ANËTARE
TË ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT DHE TË
VENDEVE PARTNERE TË KËSAJ ORGANIZATE NË STËRVITJEN E
PËRBASHKËT “DEFENDER EUROPE 21”**

Në mbështetje të neneve 12, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate (në vijim, trupa aleate) në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3100 (tre mijë e njëqind) trupave aleate, pjesëmarrëse në stërvitje.

Neni 3

Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në paketën e stërvitjeve “Defender Europe 21” është demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe të NATO-s në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks, në poligone e terrene stërvitore.

Neni 4

Stërvitja “Defender Europe 21” zhvillohet në periudhën 26 prill – 20 qershor 2021 në Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, në garnizonin “Skënderbej”, në bazën ajrore të Farkës, në bazën ajrore të Kuçovës dhe në poligonet stërvitore të Bizës e Fekenit, si dhe në rrugëkalimet ajrore e tokësore për në këto rajone.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 3100 (tre mijë e njëqind) trupa aleate, 10 (dhjetë) anije, 18 (tetëmbëdhjetë) avionë, 19 (nëntëmbëdhjetë) helikopterë, 6 (gjashtë) sisteme raketash patriot dhe 1000 (një mijë) automjete joluftarake, të cilat kryejnë lëvizje gjatë 24 (njëzet e katër) orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 6

Trupat e vendeve aleate gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë kanë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19.6.1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat e vendeve aleate shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.3.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 12015, datë 11.3.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**